

Fillimi > -Kronikë

E rëndë në Lezhë/ Arrestohen 3 të rinj për kokainë, zbulohet se 2 prej tyre kishin përdhunuar një të mitur

25 Nëntor, 2022 10:27



Madhësia e tekstit: - +

- Finalizohet operacioni policor i koduar “Ndëshkimi” në Lezhë, arrestohen 3 të rinj, një 16-vjeçar në kërkim për drogë.
- Gjatë operacionit rezultoi se 2 prej këtyre shtetasve kishin kryer marrëdhënie seksuale me dhunë, me një shtetase të mitur.
- Gjatë operacionit, shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan një pako të mbushur me dhjetëra doza lënde të dyshuar narkotike kokainë, të gatshme për shitje, 1 peshore elektronike, 1 kallëp tritol, kapsolla detonatore dhe sende të tjera të kundërligjshme.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisarariatit të Policisë Lezhë, bazuar në inteligjencën informative se disa të rinj kryenin në qytetin e Lezhës, veprimtarinë kriminale të shitjes së lëndëve narkotike (kryesisht kokainë), në doza, kanë organizuar dhe finalizuar operacionin policor të koduar “Ndëshkimi”.

Në kuadër të këtij operacioni, u bë kapja dhe arrestimi në flagrancë i shtetasve:

- Indrit Puka, 20 vjeç, banues në Lezhë, i dënuar më parë për drejtim të automjetit, nën efektin e lëndëve narkotike;
- Armando Gega, 19 vjeç, banues ne Lezhë, i dënuar më parë për vjedhje;
- Klevisian Toni, 20 vjeç, banues në fshatin Kolsh, Lezhë.

Bazuar në inteligjencën informative se këta 3 shtetas shpërndanin lëndë narkotike, të cilën e mbanin në banesën e një 16-vjeçari, shërbimet e Policisë kanë ushtuar kontroll në këtë banesë dhe si rezultat, kanë gjetur dhe kanë sekuestruar një pako të mbushur me lëndë të dyshuar narkotike kokainë, të ndarë në dhjetëra doza, të gatshme për shitje, 1 peshore elektronike, 1 kallëp tritol, kapsolla detonatore dhe sende të tjera të kundërligjshme.

Në momentin e kontrollit, 16-vjeçari, në banesën e të cilit u gjetën sendet e kundërligjshme, nuk është gjetur në banesë dhe është shpallur në kërkim. Vijon puna intensive për kapjen e tij.

Gjithashtu, gjatë këtij operacioni rezultoi se shtetasit Indrit Puka dhe Armando Gega, në banesën e 16-vjeçarit, kishin kryer marrëdhënie seksuale me dhunë, me një shtetase të mitur 15 vjeçe, e cila është paraqitur në Komisariatin e Policisë dhe në prani të prindërve, psikologut dhe avokatit, ka bërë kallëzim për këta 2 shtetas.

Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, për veprime të mëtejshme, për veprat penale “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me dhunë me të mitur të moshës 14-18 vjeç” dhe “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, në ngarkim të shtetasve Indrit Puka dhe Armando Gega, ndërsa në ngarkim të shtetasve Klevisian Toni dhe të 16-vjeçarit, materialet u referuan për veprat penale “Mbajtja pa leje e armëve, armëve shpërthyes dhe municionit” dhe “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”.

Për t'u bërë pjesë e grupit "Balkanweb" mjafton të klikoni: [Join Group](#) dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. [Grupi Balkanweb](#)

Etiketa: Droge kokaine lezhe perdhunim

TË NGJASHME



Armë, para dhe 430 kg kokainë/ Dalin pamjet e operacionit në Fier, si u zbulua banesa e zyrtarit të PS, policia 'blindo' fshatin në pak minuta

25 Nëntor, 2022



Shkatërrohet banda e drogës në Angli/ Klientët porosisnin me telefon dhe..., si funksiononte skema 'geniale' e 4 shqiptarëve

25 Nëntor, 2022

TË FUNDIT NGA -KRONIKË



Lëvizte pa patentë në mes të Hamburgut, të riut shqiptar iu gjet në makinë dhe....

25 Nëntor, 2022



U arrestua për kokainën në Fier, ish-kryekomunari i PS punonte si drejtor në OST, varësis i Belinda Ballukut me rrogë 2 milionë lekë

25 Nëntor, 2022



Raporti Botëror, Shqipëria në mesin e 10 vendeve të para për kultivimin dhe shitjen e kanabisit

25 Nëntor, 2022




Aksidenti të moshuarin që më pas ndërroi jetë, përfundon në pranga 56-vjeçari në Fier (EMRI)

25 Nëntor, 2022



Laboratori i drogës në Frakull, zbulohet roli i kolumbianëve. Zbardhet itinerari i ngarkesës me kokainë në pleh kimik

25 Nëntor, 2022



Përfashkimi i Shefit të komisarariatit dhe ai i Krimeve në Berat, kush janë emrat që i zëvendësojnë

25 Nëntor, 2022

KATEGORIA VIDEO



"Izolimi duke mohuar liberalizimin e vizave, i padrejtë", Xhaça nga Prishtina: Mbështesim aspiratat e Kosovës për integrim euroatlantik

25 Nëntor, 2022



Armë, para dhe 430 kg kokainë/ Dalin pamjet e operacionit në Fier, si u zbulua banesa e zyrtarit të PS, policia 'blindo' fshatin në pak minuta



"Porositi vrasjen e avokatit", Gjikhuri komenton akuzat ndaj Taulant Ballës: Nuk e di vërtetësinë, pyesni...

25 Nëntor, 2022



Zgjedhjet dhe situata në PD, Murati: Dy grupimet janë në të njëjtën 'varkë', por lundrojnë me rrema në krahë të kundërt

25 Nëntor, 2022



Uni-klima hap showroom-in e sistemeve të kondicionimit Mitsubishi Electric

25 Nëntor, 2022

